

DHORI Q. QIRJAZI
Universiteti i Selanikut
kyrdoris@lit.auth.gr

«PLAKUSTATHI» OSE ALTER EGO-JA E TH. MITKOS

Objekti i kësaj kumtese ka qenë përvijuar pa u gjetur materiali vetë! Në abstraktin që patëm dërguar për konferencën kushtuar përkthimit të greko-shqiptare / shqiptaro-greke (Tiranë, dhjetor 2014¹), shkruanim paragrafin e mëposhtëm, që po e riprodhojmë këtu të plotë:

Rast tjetër, i pakomentuar deri më sot, i përkthimit të një vepre etologjike nga greqishtja, është edhe vepra e pabotuar ende e Th. Mitkos me titull Plaku Stathi. Ndonëse nuk e kemi parë dorëshkrimin nga afër, mbi bazën e përshkrimeve të prof. J. Bulos², kemi bindjen thuajse të plotë se ai përbën një përkthim të Mitkos të veprës O Gerostáthis të shkrimtarit bashkëkohës të Mitkos, Léon Melás. Siç shkruajnë antologjitë e prozës greke të shek. XIX, ajo vepër shërbeu si burim frymëzimi e dashurie atdhetare për breza të tërë të grekëve. Duke e përshtatur në shqip Mitkoja dëshironte t'iu drejtohej edhe brezave të rinj të shqiptarëve. Përmbajtja e saj është e tillë sa nuk lë fije dyshimi për faktin se Mitkoja gjen te Plaku Stathi alter ego-n e vet.

Në vazhdim, në sajë të ndihmës së kolegëve J. Bulo, Sh. Sinani e S. Gjoni, u bë e mundur të gjendej njëri nga dorëshkrimet e Mitkos, prej 138 faqesh, i depozituar vite më parë në Arkivin e IGJL Tiranë³. Kolegun A. Spiro, që mori përsipër fotografimin e dsh për llogari të mikut kurbetlli, si dhe miqtë e lartpërmendur, do të desha t'i falënderoja në emër të "Plakustathit"⁴ dhe timin. Detyrime të tjera nuk na kanë lejuar të vazhdojmë kërkimin edhe për dorëshkrimin tjetër, me një numër më të vogël faqesh, por kemi shpresë se kjo punë do të kryhet në muajt e ardhshëm⁵.

¹ "Rrugëtime gjuhësore kulturore shqiptaro-greke". Konferencë për përkthimtarinë greko-shqiptare dhe shqiptaro-greke, organizuar më 5.12.2014 nga Dega e Greqishtes e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës.

² Shih shkrimin "Në gjurmët e rilindësve", në: J. Bulo, *Magjia dhe magjistarët e fjalës*, Dituria, Tiranë 1998, 215, ku thuhet se "Krijimet në lëmin e prozës, sidomos një novelë e gjatë me problematikë etologjike, e titulluar 'Plaku Stathi', na japin të drejtën këtej e tutje të flasim për Mitkon jo vetëm si publicist, etnolog, gjuhëtar e poet, por edhe për Mitkon prozator". Edhe pse e vërteta qëndron pak më ndryshe, çka do të thotë se kemi të bëjmë me një vepër të përkthyer, (për të cilën, së paku deri më tash, nuk ka patur asnjë indikacion direkt), prof. Buloja ka të drejtë kur flet për Mitkon prozator. Delli prej prozatori e rrëfimtari i Mitkos shfaqet edhe këtu me ringjizjen shpesh të admirueshme që ai i bën lëndës së origjinalit.

³ Sipas kopjes së proces-verbalit përkatës, që prof. J. Buloja pati mirësinë të na e bënte të ditur.

⁴ Këtu ndjekim mënyrën si e shkruan dhe e lakon fjalën vetë Mitkoja.

⁵ Ekzistenca e tij vërtetohet edhe nga një kumtesë e studiuesit Th. Gjika, mbajtur në qershor 1988 në Korçë, në sesionin shkencor kushtuar 110-vjetorit të botimit të "Bletës Shqiptare". Këtë të dhënë pati mirësinë dhe na e vuri në dukje kolegu A. Spiro. Sipas

Dorëshkrimi që kemi në duar fillon nga faqja 5 dhe vazhdon me numërim të rregullt dhe pa vështirësi në të lexuar deri në faqen 138. Kjo do të thotë se, së paku për momentin, na mungojnë fletët e para, ku ndoshta ka patur edhe ndonjë shënim a hyrje të vetë Mitkos për qëllimet dhe përmbajtjen e përkthimit në fjalë. Më poshtë do të paraqesim një fragment të përkthimit, shoqëruar nga origjinali greqisht, që e japim në fund të çdo faqeje.

Të shumtë ata që quhen të krishterë, por për fat të keq të paktë të krishterët e vërtetë, që jo vetëm besojnë në Krishtin, por edhe bëjnë ato që na mëson Krishti. Ndër këta të paktë bënte pjesë edhe i miri Plakustathi. Besnik në sa na mëson Kisha Ortodokse, i përmbushte ngaherë me përkushtim detyrat shpirtërore dhe lëndore të të krishterit të vërtetë. Shpeshherë thosh se⁶ [f. 5] në stërvitëshim që vogëliet të çpërblenjëm plot e mirë të bukurat porosiat e Krishtit, ashtu sa të silleshim' e të shkonim' vërtetë kërshterimshim jo vetëm' përbrenda kishës, po edhe jashtë shoqmeshoq ndëpër nevolat tona të kësaj jete, sëra e rrjeshta që drejton kaqe maanitçim gjithë trupat e qiellit, dotë mbretëronte paa-droë edhe ndër njerëzit mbi dhët⁷.*

Ndonëse umplak ndë dhe të huajë Plakustathi, asnjë ças ... nuku harroi të dashurën mëmdheën e tij, as tëmënë, një plakë pra, e cila që shumë vjetesh po qante vdekëjën e të shoqitë saj, edhe mërgimin* e së birit⁸.

As lakëmia e arit, as kënaqiat / përgëzimet e ëmbëlsiat e jetësë Europës, mprapsnë dot Plakustathin mbë të nkëthyerë ndë vënt të tij, që ish lindurë. Përse mun ndë fletë të zemërës ndiente dëtyrën shenjhtë për të xdfryerë të smundmen mëmën e tij, e për të bër' edhe ndonjë të mirë, me sa t'i mundej mëmdhesë tij⁹.

kronikës së sesionit, në kumtesën me titull “Plaku Stathi’ – një dorëshkrim i Th. Mitkos dhe fillimet e prozës sonë tregimtare” jepen të dhëna për një dorëshkrim në 169 faqe fletoresh që përmbajnë pjesë të një novele të shkruar nga Thimi Mitko (kursivi ynë – Dh.Q.Q.). “Novela ... duket se është origjinale, ka frymë didaskalike dhe është shkruar rreth viteve 1880-1885. Autori i kumtesës ... i quajti këto pjesë të novelës si fillime të prozës së gjatë shqipe, duke pasur këtu parasysh prozën artistike me temë laike”. *Kultura Popullore*, viti IX, 2 (1988) 239.

⁶ Me shkronja korsive jepet pjesa e përkthimit që është kryer prej nesh për arsye plotërie të tekstit. Originali greqisht është si vijon: Πολλοί οι λεγόμενοι Χριστιανοί, αλλά δυστυχώς όλίγοι οι αληθείς Χριστιανοί, οί ούχι μόνον πιστεύοντες είς Χριστόν, αλλά και πράττοντες τὰ του Χριστού. Έκ τών όλίγων δέ τούτων ήτο και ό άγαθος Γεροστάθης. Πιστός είς τὰ δόγματα τής Όρθοδόξου Έκκλησίας, μετ' εύλαβείας πάντοτε έξεπλήρου όλα τὰ έξωτερικά και έσωτερικά καθήκοντα του άληθοϋς Χριστιανού. Πολλάκις δέ έλεγεν ότι,

* ose rreéshta, sëra = η τάξις [rendi]

⁷ εάν έκ νεαράς ήλικίας συνειθίζομεν πάντες είς τήν άκριβή έκπλήρωσιν τών θείων του Χριστού παραγγελμάτων, ή άρμονία, ή τόσον θαυμασίως διέπουσα όλα τὰ ούράνια σώματα, ήθελε βεβαίως βασιλεύει και μεταξύ τών ανθρώπων επί τής γής.

* largimin e së ...

⁸ “Αν και έγήρασεν επί τής ξένης γής ό Γεροστάθης, οϋδεμίαν όμως στιγμήν έπαυσεν ένθυμούμενος τήν φίλην πατρίδα του και τήν γραίαν μητέρα του, ήτις προδ έτών ήδη έκλαιε και του συζύγου της τόν θάνατον, και του υίου της τήν στέρησιν.

⁹ Οϋτε του χρυσίου ή δίψα, οϋτε τής Εύρωπαϊκής ζωής τὰ θέλγητρα έμπόδιαν τόν Γεροστάθην του να επανέλθη είς τήν γεννήσασαν αύτόν κωμόπολιν· διότι, και τó καθήκον του να παρηγορήση τήν άσθενή του μητέρα ζωηρώς συνησθάνετο, και χρέος ίερόν αύτου έθεώρει να συντελέση κατά δύναμιν είς τής πατρίδος του τήν βελτίωσιν.

Përandaj, tyke punuar me nder e me kurcim, posa fitoi një shumë- cazë aspëra*, edhe njohu se muntte të rronjë prëhurshim, edhe mëmdhesë dashurë të'i ndihnjë me hieshim, vuri haromat e tija ndë një Tryesë të saktë të Ruisë, edhe lëreu gjith' ato të mira kënaqia e prëhëja pëlqime (tek- pa ka edhe të liga ndër to) të së qytetësuarës Europë, e unkëthye ndë katun të tij, tek me lote gazi përqafoi të përdashurën mëmë, edhe gjithë miqt' e çunërisë tij¹⁰.

Këtu paraqitëm vetëm disa radhë nga pjesa hyrëse e “Plakustathit”, prej së cilës mësojmë mjaft gjëra si për heroin e librit, ashtu edhe për arsyet pse shkrintari Léon Melás e shkroi atë. Në fakt, kush e njeh sadopak jetën e Mitkos, e kupton në sa shumë pika përrputhet ajo me jetën e Plakustathit. Po sjell si shembull vetëm një paragraf:

Plakustathi jetoi shumë mote në dhé të huaj, nëpër qytetet e Ruisë, Austrisë, Francës dhe Italisë. Dijedashës si gjithnjë, i papërtuar e sedërlli, as kohën e shkonte kot, as virtytet e thjeshtësinë i braktisi, por edhe tregtisë iu kushtua me dëshirë, edhe gjuhë të huaja mësonte me zell, edhe studimit të librave moralë, historikë dhe filologjikë i kishte hyrë me përkushtim, edhe hapat e vërtetë të mbrothësisë europiane i ndiqte me kujdes.

Libri me titull «Ο Γεροστάθης» u botua më 1858 dhe, siç lexojmë në faqen elektronike të shtëpisë botuese prestigjioze greke IANOS, deri më sot janë shitur 900.000 kopje të tij, duke e renditur kështu ndër njërin prej librave më të shitur në Greqi. “Ky best seller diakronik ka qenë ushqim shpirtëror breznish të tëra greke, ngaqë gërsheton hijshëm mjaft njohuri, dhe me mprehtësi të admirueshme pedagogjike ofron këshilla të dobishme”, mësojmë nga i njëjti burim¹¹. Historiani i letërsisë së re greke dhe njëri nga njohësit më të mirë të periudhës së iluminizmit grek dhe të lidhjeve të këtij me iluminizmin francez, studiuesi K.Th. Dhimarás, shkruan se “Plakustathi, përshtatje e një veprë të huaj, frënge, nuk është roman: e shkruar për t’iu dhënë këshilla të rinjve, me anë shembujsh dhe në kuadër të një fabule të thjeshtë arrin të japë rrëfime të shkurtër, marrë prej burimesh të larmishme e sidomos nga lashtësia. Libri, i shtypur në kohën e duhur, u lexua shumë”¹². Studiuesit e kësaj veprë¹³ kanë vënë në dukje se ajo u bazua në një libër francez, me titull *Simon de Nantua ou le marchand forain*, botuar në Paris më 1818¹⁴. Autor i veprës është shkrintari francez Laurent-Pierre de

* hollovē και (αλβ.λατλ.) harómē-a — χρήματα ως και turrés (γραικιστί τουρνήσιν) = χρήματα.

¹⁰ “Αμα λοιπόν δια τῆς φιλοπονίας, οἰκονομίας καὶ τιμιότητος ἀπέκτησε χρηματικὴν τινα κατάστασιν, δι' ἧς καὶ αὐτὸς ἀνέτως ἠδύνατο νὰ ζήσει, καὶ τὴν πατρίδα του ἀποχρώντως νὰ περιθάλλῃ, εἰπὼν τὸ χαῖρε εἰς τὰ ἀναμεμιγμένα καλὰ καὶ κακὰ τῆς πεπολιτισμένης Εὐρώπης, ἐπανῆλθεν εἰς τὴν κωμόπολιν του, ὅπου μετὰ δακρύων χαρᾶς ἐνηγκαλίσθη καὶ τὴν φιλότιμην μητέρα του καὶ τῆς νεότητός του τοὺς φίλους.

¹¹ <https://www.ianos.gr/o-gerostathis-igeia-tis-kardias.html>

¹² Κ.Θ. Δημαράς, *Ιστορία της Νεοελληνικής Λογοτεχνίας. Από τις πρώτες ρίζες ως την εποχή μας [Histori e Letërsisë së Re Greke. Nga fillimet e hershme deri në ditët tona]*. Ίκαρος, Athinë 1987, 329.

¹³ Shih K. Μαλαφάντη, Ο Λέων Μελάς (1812-1879) ως λογοτέχνης-παιδαγωγός και το έργο του [Leon Melas-i (1812-1879) si letrar-pedagog dhe vepra e tij]. *Παρνασσός ΜΗ'* (2006) 359-406.

¹⁴ *Simon de Nantua ou le marchand forain*, A Paris, chez L. Colas, Imprimeur-libraire de la societe pour l'instruction elementaire, 1818.

Jussieu (1792-1866). Nga ana tjetër, në përshtatjen greqisht të saj gjejmë elemente autobiografike të vetë Melás-it, si dhe të tregtarit dhe mirëbërësit nga Korfuzi, Fílipas Lavrános, që e ndihmoi atë të kryente studime për jurisprudencë në Itali¹⁵. Po ashtu, janë vënë re aty edhe gjurmë të iluminizmit si dhe jehona e ideve të A. Korais-it, ndaj të cilit Melás-i (edhe Mitkoja¹⁶) ushqente respekt të veçantë¹⁷.

Kur vdiq L. Melás-i (1879), i njohur tashmë si autor i “Plakustathit”, poeti bashkëkohës A. Paráschos shkroi vargjet e mëposhtme:

Αν ο Μελάς απέθανε, // ο Γεροστάθης μένει. // Πέσαν του δέντρου τα κλαδιά // Μα ο κορμός του στα παιδιά, // Αυθίζει και βλασταίνει!¹⁸

[Edhe pse vdiq Melási // Mes nesh mbet’ Plakustáthi. // Degët e drus’ edhe pse ranë // lulja dhe gjethi çel sërish // në kurm të vogjëlís’].

Tani, pas daljes në dritë të “Plakustathit”, mund ta rendisim atë krahas *Fjalorit* dhe *Doracakut bisedimor trigjuhësh italisht-greqisht-shqip*¹⁹, të përshtatur nga Mitkoja²⁰, si dhe ta vendosim në një paradigme me përkthimin “*Mirëvetija*” të Vretos dhe me “*Bagëti e Bujqësi*” të N. Frashërit. Pavarësisht dallimeve dhe nivelit artistik, ato vepra i shërbejnë mbrytjes morale të qytetarëve të kohëve të reja, dhe kjo ka qenë një ndër shtyllat e veprimtarisë iluministe e patriotike të Mitkos.

Në kuadër të gjurmimit të ndikimit të ideve të iluminizmit francez në Ballkan e të zig-zageve të tyre nga njëri vend në tjetrin, është me interes të vihet në dukje se me “Plakustathin” kemi një rast të dytë²¹, në të cilin, krahas “*Mirëvetisë*” së Vretos²², një vepër e shkruar në Perëndim përkthehet fillimisht në greqisht e, më pas, prej kësaj në një gjuhë tjetër ballkanike, konkretisht në shqip.

¹⁵ Β. Κραψίτη, *Λόγιοι της Ηπείρου [Savantë të Epirit] (1430-1912)*, Athinë 1979, Vëll. I, 254.

¹⁶ Në Fondin Mitko kemi gjetur mbi 10 fletë ku 24-vjeçari asokohe Mitko ka mbajtur shënime nga leximet e veprës së Korais-it.

¹⁷ Siç vëren K. Malafandis, *op.cit.*, 368, “pak muaj pas qarkullimit të librit [francez], në qershor 1818, Adamandios Korais-i, i cili ndodhej përherë në ‘gadishmëri’, duke e nuhatur vlerën pedagogjike të librit, nxiton t’ia rekomandojë mikut të vet I. Rotas si ‘të dobishëm për t’u përkthyer në gjuhën tonë të sotme’”.

¹⁸ Β. Κραψίτη, *op.cit.*, 255.

¹⁹ Shih Thimi Mitko, *Fjalori Italisht-Greqisht-Shqip. Dorëshkrimi origjinal*. Përgatiti Shpëtim Sala. I. Tiranë, West Print 2013; dhe Shpëtim Sala. *Fjalori Italisht-Greqisht-Shqip i Thimi Mitkos. Transliterimi dhe fjalësi shqip*. II. Tiranë, West Print 2013.

²⁰ Shih edhe sa thuhet për këtë përshtatje në studimin tonë hyrës të Thimi Mitko, *Fjalëtore Shqip-Gërqisht / Gërqisht-Shqip & Ndihmesa të tjera leksikografike, (Përgatitja e dorëshkrimeve për botim dhe studimi hyrës nga Dh. Q. Qirjazi)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2014, 59-63.

²¹ I dytë për sa i përket daljes në dritë të këtij fakti, sepse kronologjikisht “Plakustathi”, i shkruar rreth viteve 1870, i paraprin “*Mirëvetisë*” së botuar më 1886.

²² Shih edhe shkrimin tonë, “*Mirëvetija*” – η πρώτη αλβανική χρησιμοποίηση και το ελληνικό της πρότυπο [“*Mirëvetija*” – libri i parë etiko-didaktik shqiptar dhe gjedhja greke e tij], *Albanohellenica* 2 (200-2001) 95-100.

Një linjë tjetër, që mund të trajtohet në frymën e “Plakustathit”, është respekti i thellë që ushqen Mitkoja për bamirësit korçarë, çka duket në shkrimet kushtuar atyre prej tij²³, si dhe në fjalët që ai i drejton rinisë së Korçës:

*Fort e dashura rini e Korçës! Ti shpresë e dheut të rilindur atëror! Hapni sytë dhe mos u tundoni kurrë nga pija shkatërruese e përfitimt të pacipë dhe e etjes për pushtet të aristokratëve. Jini krenarë e trima për dheun mëmë, [...]. Shfaqni me nderim të thellë mirënjohjen ndaj dedikuesve dhe bamirësve tuaj, tregohuni të denjë ndaj bamirësisë së tyre.*²⁴

Mitkoja nuk gjen tek Plakustathi vetëm *alter ego*-n e vet. Ai gjen aty edhe një shembull të asaj çka mund të bëjnë kurbetllinjët për mbrohtësinë e atdheut. Në këtë kuptim, “Plakustathi” na ndihmon ta rimarrim e ta rivendosim në një këndvështrim të ri çështjen e bamirësve jo të paktë që nxori (sidomos) jugu shqiptar e të cilët deri më sot ose janë harruar ose janë anatemuar²⁵.

Motoja e Mitkos, thelb i kuptimit të tij për bamirësinë, ka qenë “... të mirën që po bëjmë sot, zot’ i jetës do na e shpërblejë”²⁶. Duke rrëmuar në dorëshkrimet e tij, ramë në gjurmë të një flete ku, me një alfabet tjetër, bazuar në atë grek, por të ndryshëm nga ai i Kamardës, që Mitkoja e adoptoi për botimin e “Bletës Shqiptare”, janë ruajtur 28 vargje të Mitkos kushtuar Jovan Bankës:

*A e msove ti moj Korçë * djemt’ e tu çë kërkojnë / dëshërojnë
që gjuën të ta shkruajn * që gramatë të mbësojnë
që reçperí përjashta * më tepër katërqint veta
Misir e Stamboll Vllainë * që sjellën posi bleta.
Që të të madhonjinë * të dukesh pre Shqipërisë
gjithë burrat të nderojnë * me punrat të reshperisë.
Kemi kaqe babavendës²⁷ * këtë ndiën gjith’ ata
po përpiqen për të mirat * edhe me punë edh’ me pará.
Dolli posi yll mëngjezi * që do të rrëfenjë ditë
Jovan Banka i Vllaisë * të ngjallenë vëllazëritë.
Perëndia na e fali * me shpirtin të shentëruar
gjithë dirsën që punojti * ty ta ka për të dhuruar.
Ju o vëllzër lavdëroni * Perëndisë të na rronjë
Jovan Banka zot i mirë * Korçënë të na nderonjë.*

²³ Shih p.sh. *Inno ad Abramidhi*, Fiamuri Arbërit, anno II, num. 4, 20 Agosto 1885, si dhe shkrimet e Mitkos për J. Bankën, që përmenden në vazhdim të punimit tonë.

²⁴ Thimi Mitko, *Fjalëtore ...*, 81-82.

²⁵ Edhe pse cilësimi që po i bëjmë tingëllon kundërthënës, njëri nga bamirësit e parë, dhe të dëshmuar, njeriu që bëri përpjekje për shkollimin e shqiptarëve në Perëndim, ka qenë Ali Pashë Tepelena!

²⁶ Letër e Th. Mitkos për V. Dodanin, në: Thimi Mitko, *Vepra*, përg. Q. Haxhihasani, Tiranë 1981, 707.

²⁷ Kjo fjalë, që nuk e kemi hasur gjetkë, është me sa duket një kalk i ndërtuar mbi bazën e fjalës patriot (-πατριώτης), në rrënjën e së cilës qëndron fjala πατήρ ‘atë, baba’.


Nën' e babë që e polli * *qe e mir pe Perëndie*
 Jovan Bankën që na solli * *ndriçin shpirt e asaj shpie.*
 Është lëvdatë e Korçës * *nga Perëndia thënë ishte*
 ka u zot le të e mpsonjë * *për një jimnasio elinishte.*
 Me gjuën të diturisë * *ndë jimnasio edh gramat tona*
 me gjuën të Shqipërisë * *ndë këtë dritë eona.*
 Emëri të mos i vdesë * *shpirtinë të ja lavdojnë*
 mb' atë emër kemi shpresë * *djemtë tanë të na mpsojnë*
 të parën bëri të mirë * *solli ujë lagu dhenë*
 Perëndia i dhëntë jetë * *për korçarët që ta kenë.*
 Zot' i qellit le ta mpsonjë * *Korça të arrinjë ditë*
 Një jimnasio të dhuronjë * *djemtë tanë jan të titë.*
 Elinishte edh' gjuja shqipe * *të dya me gramatikí*
 Që të dya janë tonat * *për djemtë ndë Shqipëri.*

Ndonëse dorëshkrimi i lartpërmendur lexohet me vështirësi dhe, prandaj, nuk përjashtohet mundësia e ndonjë pasaktësie në transkriptimin që kemi kryer, thelbi i asaj çka don të transmetojë Mitkoja është mjaft i qartë.


Në Fondin Mitko ruhet edhe një shënim i shkurtër i Th. Mitkos për J. Bankën, shkruar më 28 qershor 1870, të cilin për arsye vendi po e anashkalojmë. Po ashtu, kemi gjetur aty edhe një copë gazete të Athinës (“Αλήθεια”, 3.10.1869), ku lëvdohet shembulli i atyre që “djersën e depozituar e sakrifikojnë në të mirë të atdheut”.

Duke qenë se kemi ndërmend të kryejmë botimin filologjik të përshtatjes së kryer nga Th. Mitkoja, po mjaftohemi këtu me pohimin se, në rrafshin gjuhësor, “Plakustathi” shërben si trualli ku marrin jetë lemat e Fjalëtores shqip-gërqisht të Mitkos, të cilat deri më sot i konsideronim statike dhe ndonjëherë krijime *ad hoc*, që nuk e kishin kaluar “provën e zjarrit”. Shohim tani se shumica e tyre janë njësi leksikore që Mitkoja i hedh në përdorim shumëplanësh duke plotësuar kështu njëri nga mangësitë e Fjalëtores dhe të punës së vet leksikografike, mungesën e shembujve ilustrues prej nga rrjedhin dhe duken natyrshëm kuptimet dhe ngjyrimet e fjalëve. Për punë të neologjizmave dhe përgjithësisht të fjalëve që kanë ndërruar kuptim në shqipen e sotme, na vjen në ndihmë teksti i originalit greqisht, që do të vendoset në krah të përshtatjes shqip të Th. Mitkos²⁸.


²⁸ Në mbyllje të kësaj trajtese të shkurtër, nuk mund të lë pa përmendur atë burrin fisnik prej Dervicanit të Gjirokastrës, të cilin e takova para disa ditësh në stacionin e autobuzëve të Selanikut. “Pres djalin”, më tha. “Vjen për kontrollin e radhës në spitalin ‘Papanikolaou’. Tani, lavdi Zotit, e kaloi rrezikun!”. Djali është një i ri nga anët e Labërisë së Vlorës, mustaqepadirsur, që mbahet në jetë falë kujdesit dhe përkushtimit të disa njerëzve të mirë, shqiptarë e grekë, të cilët i çelën së pari dyert e zemrës e më pas arritën të ‘çelin’ edhe dyert e një klinike speciale në Selanik!”. Edhe pse deshën të mbeten anonimë, më duhet t’u them se Mitkoja dhe Plakustathi do të ngazëlleshin po ta dëgjonin këtë histori. Sepse bamirësia dhe njerëzillëku nuk janë thjesht dhe vetëm punë parash!



Ballina e botimit III të librit «Ο Γεροστάθης», Athinë 1862.



Faqja V e dorëshkrimit të “Plakustathit”. Katër të parat mungojnë.



Vjershë e Th. Mitkos për bamirësin korçar Jovan Banka, shkruar me një alfabet të ndryshëm nga ai i “Bletës shqiptare”.

Περίληψη

Το πεζογράφημα “Plakustathi” θεωρούνταν μέχρι πρόσφατα πρωτότυπο έργο του Ε. Μήτκου, ηθικοπλαστικού περιεχομένου. Η προσεκτική εξέταση των χφφ μάς οδηγεί στο συμπέρασμα ότι πρόκειται για διασκευή από το Μήτκο του εκδοθέντος το 1858 βιβλίου του Λ. Μελά, με τίτλο «Ο Γεροστάθης». Ο Ε. Μήτκος όχι απλά διασκευάζει, αλλά και βρίσκει στο Γεροστάθη το alter ego του. Με δεδομένο ότι το βιβλίο του Μελά βασίστηκε σε γαλλικό έργο, που εκδόθηκε το 1818, μπορούμε να φανταστούμε την ενδιαφέρουσα διαδρομή των ιδεών του γαλλικού διαφωτισμού στα Βαλκάνια.